



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2019

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit për vitin 2018

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit plotësues Nr.1, datë 17.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, si edhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit” ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2018, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për programin:

- Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- **Zbatimi i Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” në disa drejtime:**
 - ✓ Identifikimi, mbledhja dhe administrimi i dokumenteve të prodhuara nga ish- Sigurimi i Shtetit në periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991
 - ✓ Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
 - ✓ Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.

- ✓ Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji 45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
- ✓ Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale dhe e drejta për informim
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Autoriteti në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për cdo kërkesë të paraqitur nga:

1. Institucionet për:

- ✓ verifikimin e zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë;
- ✓ verifikimin e kandidatëve për funksione të zgjedhshme;
- ✓ verifikimin e propozimeve për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit.

2. Individët për:

- ✓ njohje në cilësinë e; - të prekurit; - palës së tretë; - bashkëpunëtoreve; - të favorizuarëve të Ish-Sigurimit të Shtetit.
- ✓ rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ dëmshpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ✓ qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve

3. Studiuesit dhe Media për qëllime:

- ✓ kërkimore;
- ✓ historike;
- ✓ edukimi.

ndjek procedurat si më poshtë:

Për cdo kërkesë të paraqitur nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Media, Autoriteti:

- ✚ Pararakisht shqyrton dhe trajton në mbledhje të Autoritetit, legjitimitetin e kërkesës së paraqitur, duke vendosur ndjekjen e procedurave në vijim dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës.
- ✚ Dërgon shkresat për vazhdimin e procedurës institucioneve përkatëse, për kontrollin dhe verifikimin e figurës së personave, sipas të dhënave të identitetit të tyre dhe në rast mungesë të dhënash, bën me dije shkresërit institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e të dhënave plotësuese sa më shpejt,

me qëllim administrimin e dokumentacionit përkatës dhe vijimin e shqyrtimit të tij nga Autoriteti.

- ✚ Kryen procesin e verifikimit të figurës së shtetasit mbi bazën e objektit të kërkesës, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e deklasifikimit të dosjeve dhe bën bibliografinë e secilës (dosje formulare, dosje përpunimi, dokumente, fashikuj etj), në rastin kur dokumentacioni i administruar është i klasifikuar.
- ✚ Kryen përpunimin e dokumentacionit, para se ai t'i vihet në dispozicion kërkuarit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 45/2015.
- ✚ Kryen trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuari në mbledhje të Autoritetit, mbi bazën e rezultatit të verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Mbi bazën e rezultateve të verifikimit të kryer, bazuar në vendimarrjen konkrete të Autoritetit, informon shkresërisht institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, sipas parashikimeve të nenit 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Treguesit për matjen e performancës do të jenë:

- Numri i kërkesave të institucioneve dhe individëve të trajtuar
- Koha e trajtimit të një kërkesë

Për vitin 2018, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2018	Buxheti me ndryshimet Viti 2018	Realizimi faktik Viti 2018	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	47 000	57 050	54 505	96 %

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2018, jepet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Llog	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2018	Buxheti me ndryshimet Viti 2018	Realizimi faktik Viti 2018	
				Në vlerë	
600	Fondi i Pagave	28 000	29 000	28 324	98.0%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	4 000	4 450	4 271	96.0%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	13 000	11 550	9 874	85 .0%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individë		50	50	100.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	2 000	12 000	11 986	99.8%
	T o t a l i	47 000	57 050	54 505	96%

Krahasimi i të dhënave faktike ndërmjet Autoritetit dhe Thesarit

Nr	Emertimi i programit	Shpenzimet korente		Shpenzimet kapitale		Totali		Diferenca
		Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	
1	Planifikim - menaxhim-administrim	42,519.0	42,519.0	11,986.0	11,986.0	54,544.0	54,544.0	0

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit,, ka realizuar vlerën buxhetore sa më poshtë:

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), është realizuar, në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”. Pavarësisht strukturës së miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, në të cilën janë përcaktuar numri total i punonjësve prej 60, me ligjin nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018” është miratuar numri vetëm për 30 punonjës.

Për vitin 2018, janë miratuar edhe 6 punonjës me kontratë të përkohshme, të cilët janë paguar për punën e kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

Buxheti fillestar i pagave dhe i sigurimeve shoqërore me ligjin vjetor të buxhetit ishte i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye, Grupi i Menaxhimit Strategjik me shkresën nr.1021, datë 31.10.2018 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rialokim fondesh brenda buxhetit

të institucionit nga zëri “Shpenzime operative” në “Paga dhe sigurime shoqërore” në vlerën 1 450 mijë lekë.

Për sa më sipër buxheti i pagave dhe i sigurimeve shoqërore është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **28 324 mijë lekë** për paga si dhe **4 270 mijë lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore , rreth **97 %** e fondit të planifikuar vjetor.

Niveli prej 97% është nivel shumë pozitiv për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit pasi llogaritja e shpenzimeve për këtë zë dhe shtesa për fonde është bërë në mënyrë të saktë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602 -606), për vitin 2018, pas ndryshime është në vlerën 11 550 mijë lekë.

Sipas transaksioneve të kryera në Degën e Thesarit, ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën **9 874 mijë lekë** ose **85 %**, e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

Ky fond është realizuar për:

- Shlyerjen e detyrimeve për shërbimet postare, të internetit e telefonike.
- Shpenzime për blerje furnizime të ndryshme si kanceleri, materiale për pastrim, tonera për funksionimin e pajisjeve kompjuterike, printera dhe fotokopje, etj.
- Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.
- Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Autoritetit, sigurimit të standarteve si libra dhe publikime profesionale.
- Shpenzime të përkthimit, printimit dhe publikimit.
- Shpenzime për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kryetares, Anëtarve dhe personelit të Autoritetit në aktivitete dhe takime pune të ndryshme brenda e jashtë Shqipërisë.

Në kuadër të përmirësimit të treguesve të performancës dhe realizimit të fondeve korrente të vëna në dispozicion, Grupi i Menaxhimit Strategjik së bashku me sektorin e prokurimit, ka vlerësuar në mënyrë permanente kostot e aktiviteteve për vitin 2018, për realizimin e objektivave afat shkurtër, duke i reflektuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, të ndryshuar.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investimeve, AIDSSH ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2018, përmbante 2 procedura prokurimi me tenderim (i klasifikuar) ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla.

Fondi për shpenzime kapitale (zëri 230-231)

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve kapitale sipas buxhetit fillestar është ndryshuar me shtimin e fondit për shpenzime kapitale të patrupëzuara në vlerën 12 000 mijë lekë..

➤ **Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)**

Buxheti i akorduar për këtë zë shpenzimesh me ndryshimet gjatë vitit buxhetor është 12 000 mijë lekë, e detajuar në dy projekte si më poshtë :

1- Projekti M950003- llog 231, në vlerën 11 852 mijë lekë, me emërtimin “Rikonstruksion godine”.

Rikonstruksioni i godinës ka qënë interesi më i madh nga ana e Autoritetit. Për këtë arsye, i gjithë fondi është prokuruar dhe është realizuar në masën 100 %

2- Projekti M950005- llog 231, në vlerën 134 mijë lekë, me emërtimin “Mbikyrje punimesh”, project i cili ecën paralelisht me rikonstruksionin e godinës dhe është likujduar plotësisht, me realizim 100 % të projektit.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në ligjin Nr.10296, datë 8.07.2010 ”Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë , ekonomi dhe efijencë.

Në Aneksin nr. 3 është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) nga kryerja e aktiviteteve, në zbatim të objektivave për vitin 2018.

Konkretisht si më poshtë :

Produkti A: Kërkesa të trajtuara në vit : njësia matëse e të cilit është numër

Janë paraqitur 612 aplikime nga subjekte në cilësinë e të prekurit apo familjarit të të vdekurit apo zhdukurit;

Janë përmbyllur procedurat për 305 kërkesa individuale.

Për 174 kërkesa individuale për të cilat janë mbyllur procedurat, ka rezultuar se ka dokumente të krijuara nga ana e organeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Ky dokumentacion është marrë nga Drejtoria e Arkivit, është përpunuar dhe shqyrtuar sipas kriterëve ligjore nga ana e Drejtorisë së Informacionit, ku janë përgatitur relacionet, materialet mbështetëse, vendimet, procesverbalet dhe kthimet e përgjigjeve kërkuësve, mbi bazën e vendimmarrjes nga Autoriteti, për mbylljen e procedurës dhe dhënie të dokumentacionit dublikatë aplikuesve.

Për 138 kërkesa individuale, pas verifikimit nga ana e Drejtorisë së Arkivit ka rezultuar se nuk ka të dhëna/dokumente të krijuara nga ana e organeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Drejtoria e Informacionit ka vijuar procedurën me përgatitjen e relacionit, vendimeve përkatëse dhe shkresës për përcjellje të vendimeve subjekteve aplikues me qëllim mbylljen e procedurës.

Numri i dosjeve të përpunuara dhe dorëzuar tek kërkuësit gjithsej 42 149 faqe, nga të cilat 14.983 faqe të anonimizuara.

Në total për periudhën objekt raportimi, Janar-Dhjetor 2018 rezultojnë të paraqitura në adresë të Autoritetit 53 kërkesa institucionale, të cilat janë trajtuar në mbledhjet përkatëse të Autoritetit.

Rezulton se në këtë periudhë është përmbyllur procedura për 38 kërkesa, ku janë përgatitur relacionet, materialet mbështetëse, vendimet dhe kthimet e përgjigjeve kërkuësve, mbi bazën e vendimmarrjes nga Autoriteti, për mbylljen e procedurës.

Kanë kaluar në filtrin e verifikimit të pastërtisë së figurës rreth 695 kandidatë apo zyrtarë, përpara emërimit, ngritjes në detyrë etj.

Rritje të efektivitet dhe efijencës, kanë patur edhe proceduarat e zhvilluara për vënien në dispozicion të dosjeve publikut mbështetur në objektivin strategjik *“Vendosja e dosjeve në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e aksesit në informacionin në formë dixhitale”*.

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të shtetit 105 kërkesa studimore/mediatike në total, ndër të cilat, ka praktika të mbyllura, jesisht të mbyllura dhe në proces

- a. Janë mbyllur 40 praktika (këtu futen të gjitha kërkesat studimore/mediatike të cilat i kanë kaluar të gjitha fazat e trajtimit, për të cilat në varësi gjetjes ose jo të dokumenteve të kërkuara, janë mbyllur me vendim të Autoritetit.
- b. Është gjetur dhe është dhënë informacion i pjesshëm dokumentesh për 19 kërkesa studimore.
- c. Janë në proces përpunimi 40 praktika.

Fushatë sensibilizuese për të drejtën për informim për qytetarët.

Në kuadër të objektivit strategjik *“Kryerja e veprimtarisë informuese në teren për ta prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri”*, Autoriteti e ka konsideruar fushatën sensibilizuese, si një nga prioritetet e saj strategjike të lidhur drejtpërdrejt me Planin Strategjik 2017-2020. Në këtë kontekst AIDSSH ka organizuar aktivitetet si më poshtë:

1. Puna për muzealizimin e Kampit të Tepelenës
2. Marrëveshje AIDSSH-Muzeu Gjethi
3. Edhe muret kanë veshë, 8 maj, 6
4. Ekspozitë dokumentare mbi revoltën e Spacit
5. Marrëveshje AIDSSH-PERFORM, projekt I kërkimit shkencor mbi shkencën dhe Sigurimin, 1945-1954
6. Marrëveshje AIDSSH-Instituti I Historisë “Ali Hadri” Prishtinë
7. Aktivitete të AIDSSH në institucionin homolog në Çeki
8. Ekspozitë dokumentare “Persekutimi komunist të zonën e Konispolit” në Tiranë
9. Aktiviteti “Persekutimi komunist të zonën e Konispolit” në Konispol
10. Aktivitet I AIDSSH në Berat, Malin e Tomorit, Mbrojtja e të dhënave personale dhe kleri bektashi.
11. Ekspozitë dokumentare “Persekutimi komunist të zonën e Tepelenës” në Tiranë
12. Dita Muze-Memorial Tepelenë, 23 gusht/Dekorimet Presidenti/ekspozita dokumentare/simpozium shkencor/aktivitetet N’ dritë
13. Prezantimi I aplikacionit për të zhdukurit, në bashkëpunim me ICMP, 30 gusht
14. Përkuajtimi I 70 vjetorit të Zhapokikës, në Tiranë dhe Zhapokikë
15. Këndi I kujtesës “Sabiha Kasimati” në Muzeun e Shkencave të Natyrës
16. Aktivitet I AIDSSH dhe partnerëve në Pukë dhe Iballë, për një arkiv modern
17. Aktivitete të AIDSSH në Izrael, shkëmbime me Qendrën Yad Vashem
18. Ekspozita “Mbikëqyr, terrorize, përndiq” e Stasit në hotel “Tirana”
19. Konferenca ndërkombëtare shkencore mbi internim-dëbimet, 29-31 tetor
20. Takim me të rinjtë për njohjen me të shkuarën komuniste, shkolla “P.N.Luarasi”

21. Aktivitete të AIDSSH në SHBA, me Federatën Vatra dhe Zërin e Amerikës
22. Aktivitete të AIDSSH në Rumani, në institucionin homolog e Parlamentin rumun.
23. Bashkëpunimi I AIDSSH me Wikipedian, workshop mbi komunizmin

Sfida për të ardhmen

- a. Nivel sa më të lartë transparence, kur nga administrimi dhe verifikimi i dokumenteve rezultojnë të dhëna me interes për tu njohur nga subjektet e interesuara,
- b. Standard sa më të lartë informacioni, që do të thotë, së pari gjithshka që kërkohet sipas objektit të kërkesës dhe së dyti dhënia e informacionit për gjithshka të lidhur me objektin e ligjit 45/2015,
- c. Vemëndje të shtuar të trajtimit të kërkesave me objekt, personat e zhdukur dhe për ata që nuk ekzistojnë varre, në gjetjen e mekanizmave për identifikimin e tyre,
- d. Përgatitjen cilësore të materialeve informuese mbi dokumente të ish-sigurimit të Shtetit dhe vënien e tyre në dispozicion organizatorëve, në funksion të konferencave, takimeve, ëorkshopeve, programeve trajnuese, me qëllim krijimin e një kulture gjithpërfshirëse, për njohje me dokumentacionin arkivor, të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit,
- e. Përmirësimin e procedurave të ndjekura, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për subjektet e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për vetë institucionin.
- f. Gjetjen e mënyrave dhe mjeteve më efikase për të shpërndarë informacion, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit të qytetarëve dhe rinisë në vecanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që ju përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshëm të diktaturës komunisti, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të mara autentikisht nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.
- g. Bashkëpunimin me median, të cilën e shikojmë si promotor për të gjitha grupet e interesit, vecanërisht për studiuesit duke e kthyer këtë institucion në një bibliotekë të hapur lehtësisht të aksesueshme, për të gjithë ata që u takon me ligj, ashtu siç është emërtuar edhe vetë ky institucion.

Realizimi i buxhetit për vitin 2018 u monitorua me përgjegjesi dhe u kërkua angazhimi i të gjitha strukturave të AIDSSH-së me qëllim realizimin me sa më eficientë dhe efektivitet i fondeve të planifikuara. Problematikat e konstatuara gjatë këtij viti do jenë objekt i vemendjes dhe trajtimit për vitin 2019.

Materiali është i publikuar në faqjen zyrtare të AIDSSH-së www.autoritetidosjeve.gov.al

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Skënder Vrioni

Konceptoi: Vitoria Fuqi

Data: 25.02.2019

Nr. kopje: 2 (dy)